



STATUTI

PRISHTINË, MARS 2014



Në bazë të dispozitave ligjore të aplikueshme
në Republikën e Kosovës dhe Rregulles nr. 01/2013
Për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike,
Këshilli nismëtar aprovoi Statutin

S T A T U T I I - DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

REK është një parti politike konzervative që bazohet në principet e konzervatizmit modern dhe synon të garantojë dinjitetin shpirtëror dhe aspiratat social-ekonomike të popullit, nëpërmjet zhvillimit të tregut të lirë dhe pronës private ligjore, respektimit të traditave qytetare, për një komb të bashkuar në përputhje me vlerat dhe liritë personale, në kuadër të principeve demokratike dhe rregullave të institucioneve përfaqësuese. REK zhvillon pretendimet e saj politike mbështetur në bashkëekzistencën paqësore të popujve, shteteve, racave dhe besimeve fetare. Beson në pjesëmarrjen e popullit në ndërtimin e Institucioneve Demokratike, nëpërmjet votimit të lirë dhe të fshehtë, për të realizuar një shtet të së drejtës, ku përcaktohen me kushtetutë dhe rregullohen me ligj kompetencat, pavarësia dhe balancimi i pushteteve

REK është për përshpejtimin e proceseve demokratike, reformave ekonomike, politike, kulturore dhe sociale në kuadrin e integritimit Euro-Atlantik të Kosovës.

Neni 2

REK vepron në mënyrë autonome në tërë territorin e Kosovës, ndërkaq për territoret të banuara me shqiptarë jashtë trojeve të sotme të Kosovës mbetet temë diskutimit.

Neni 3

Selia e **REK** është gjithnjë në **Kryeqendrën e Republikës së Kosovës**. Në rastet e jashtëzakonshme selia e **REK** mund të jetë aty ku gjendet edhe vet kryesia.

Neni 4

Simboli i **REK** është: rrethi me sipërfaqe me ngjyre të bardhë, kuqe dhe zi, simbolizon Djathtizmin dhe në të shkruan **REPUBLIKANET E KOSOVËS, 4 yjet të zezë** te këmbët e shqiponjës simbolizojnë bashkimin e **katër vilajeteve shqiptare**, rrethi i plotë me ngjyrë të kuqe dhe shqiponjë në mes simbolizon **Flamurin Kombëtar**. Në mes të shqiponjës është akronimi i **Republikanëve të Kosovës**. Simboli i **REK** dhe vula mund të ndryshojnë vetëm me vendimin e këshillit qendror.

Neni 5

Anëtar i **REK** mund të bëhet çdo qytetar i moshës madhore të Kosovës i cili pranon programin dhe statutin e **REK** dhe e plotëson formularin.

Anëtari i **REK** shpreh lirisht mendimin e vet për të gjitha çështjet. Ka të drejtë të zgjedhë dhe të jetë i zgjedhur në të gjitha organet e **REK**.



II - ORGANIZIMI DHE ORGANET E REPUBLIKANËVE TË KOSOVËS

Republikanet e Kosovës bëhen mbi parimin territorial brenda dhe jashtë shtetit. Format e organizimit struktural partiak nga baza janë:

- **DEGA**
- **NËNDEGA**
- **AKTIVI**

DEGA

Neni 7

Kuvendi është niveli më i lartë i organizimit të **Republikanëve të Kosovës** në nivel të qeverisjes Komunale, ka statusin e personit juridik dhe vulën. Dega përfaqëson veten brenda dhe jashtë vendit. Organi më i lartë i degës është Kuvendi. Kuvendi vendos për drejtimet kryesore të Politikës në nivel Komunal. Kuvendi i degës numëron prej **50 – 70 delegat**. Kuvendi i degës formohet nga **3 delegat** nga nëndegët. Nëndegët që numërojnë mbi **50 anëtarë** e dërgojnë një delegat më tepër. Kuvendi i degës zgjedh kryesinë e degës prej **9 – 11 anëtarë**, dhe mbahet për çdo **3 vite**.

Kryesia e degës zgjedh:

1. **KRYETARIN**
2. **DY OSE TRE NËNKRYETARË,**
3. **SEKRETARIN**
4. **ARKËTARIN, SI DHE FORMON KOMISIONET E NEVOJSHME.**
ME DEGË UDHËHEQË KRYETARI I KRYESISË SE DEGËS I CILI ZBATON VENDIMET PARTIAKE NË NIVEL KOMUNAL.

NËNDEGA

Neni 8

Nëndega është instancë e dytë e organizimit të **Republikanëve të Kosovës**. Nëndega formohet me vendimin e kryesisë së degës dhe formohet nga aktivet e një lokaliteti dhe duhet ti ketë më tepër se **30 anëtarë**. Organi ma i lartë i nëndegës është tubimi i anëtareve të nëndegës së **REK-ës** i cili e zgjedhë kryesinë e nëndegës duke e respektuar përfaqësinë e secilit aktiv. Kryesia ka mandatin prej **3 vitesh**. Kryesia e nëndegës zgjedhë nga radhët e veta:

1. **KRYETARIN**
2. **NJË NËNKRYETARË**
3. **SEKRETARIN**
4. **ARKËTARIN**

NËNDEGA ËSHTË PËRGJEGJËSE PËR PUNËN DHE ORGANIZIMIN E AKTIVIT.

AKTIVI

Neni 9

Aktivi është forma dhe celula themelore e organizimit të **Republikanëve të Kosovës**, e cila mund të formohet me jo ma pak se **5 anëtarë**. Kryesia e nëndegës aprovon vendimin e themelimit të Aktivit. Udhëheqjen e Aktivit e bënë kryetari i zgjedhur nga radhët e aktivit. Aktivi angazhohet për zbatimin në jetë të qëndrimeve Partiake si dhe angazhohet për zgjerimin e aktivit me anëtarë të rinj.

Disa aktive të një lokaliteti e formojnë Nëndegën. Aktivi në bashkëpunim me nëndegën. Organizojnë se paku një herë në vit tubimin publik me banorët e lokalitetit. Mbledhja është organi më i lartë i aktivit dhe mbahet një herë në vit. Kryetari i aktivit organizon punën në Aktiv mandati i të cilit është një vit me të drejtë Rizgjedhjeje edhe për një vit.



III - ORGANET E REK-së

KUVENDI

Neni 10

Kuvendi është organi ma i lartë partiak dhe mbahet ne çdo **4 vite**. Kuvendi i parë mbahet brenda **6 muajve** nga data e regjistrimit të partisë. Kryetari i partisë është njëkohësisht edhe Kryetarë i Kuvendit.

Kuvendi i partisë numëron varësisht nga numri i degëve të cilat dërgojnë delegatet e tyre sipas po këtij neni delegatet e tyre. Kuvendet e degëve dërgojnë nga **3 delegat** në kuvendin e Partisë. Kuvendi mban mbledhjet e veta dy herë në vit, ndërsa ato të jashtëzakonshmet sipas nevojës, më kërkesën e **2/3** të delegatëve partiak.

Delegatet e kuvendit mund të revokohen edhe para skadimit të mandatit, nëse këtë e kërkon dega deleguese, dhe për këtë vendosë kuvendi i partisë.

Neni 11

Kuvendi bie vendime me shumicën e votave të anëtarëve prezent.

Kuvendi i Partisë aprovon:

- Statutin e partisë.
- Rregulloren e punës për organet ndihmëse.
- Bien vendime, sugjerime, rekomandime.
- Miraton buxhetin dhe raportin financiarë.
- Zgjedh Kryetarin dhe anëtarët e Partisë.
- Kryetari i kryesisë është njëkohësisht edhe kryetarë i Kuvendit.
- Shqipton masat ndëshkuese.
- Formon gjykatën e nderit prej 5 anëtarëve.
- Riorganizon organet Partiake.
- Aprovon propozimet partiake në raste të jashtëzakonshme.
- Mbikëqyrë jetën organizativo-politike të Partisë.
- Cakton rendin e ditës, kohën dhe vendin e mbajtjes se Kongresit Partiak.
- Kryen edhe punë tjera te cilat parashtrihen si imperativ i kohës.

Neni 12

Në Kuvend marrin pjesë:

- Kryesia e partisë
- Kryetari i grupit të deputetëve

Më vota konsultativ në kuvend mund të marrin pjesë

- Kryetari i forumit të gruas
- Kryetari i forumit rinorë
- Ministrat
- Kryeredaktori i gazetës Partiake
- Përfaqësuesi i veteranëve

Neni 13

Kuvendi është gjithashtu organi ma i lartë në degë. Kompetencat e Kuvendit janë identike me kompetencat te kuvendit të Partisë. Kuvendi i degës numëron në harmoni me anëtarët deleguar nga nëndegët me kohë-zgjatje të mandatit sikurse për anëtarët e kuvendit të Partisë. Kryetari i degës është njëkohësisht edhe kryetarë i kuvendit të degës.



KRYESIA

Neni 14

Kryesia është organi ma i lartë operativ, dhe përfaqësues i partisë. Kryesia e Partisë është organ operativ cili zbaton në praktikë Programin, Statutin, vendimet e Kuvendit të Partisë dhe Kursit Politik.

Kryesia numëron **15 anëtarë** të cilët zgjidhen për kohëzgjatje **prej 4 vitesh** më të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e kryesisë së **REK** njëkohësisht janë kryetarët e degëve. Me vota konsultative. Në mbledhje mund të marrin pjesë edhe **Kryetarja e Forumit së Gruas**, **Kryetari i Forumit Rinorë**, dhe **Kryetari i Grupit Parlamentarë**.

Kryesia zgjedhë: **Kryetarin, 4 Nënkryetarë, Sekretarin, dhe Arkëtarin**. Me punën e kryesisë udhëheqë Kryetari dhe Nënkryetarët, në mungesën e Kryetarit, në rast nevojë mund të udhëheqë edhe Sekretari. Kryesia parashtron çështjet të cilat duet të aprovohen nga ana e Kuvendit të partisë. Vendimet e kryesisë janë të plotfuqishme nëse ato janë të votuara më mbi **50%** të anëtarëve prezent të kryesisë. Votimet për çështje programore behën më deklarim (Në mënyrë të hapur), ndërsa për çështje të kuadrove behën me vota të fshehta.

KRYETARI I REK

Neni 15

1. Kryetari i **REK** i përfaqëson **"REPUBLIKANËT E KOSOVËS"** si në vend ashtu edhe jashtë i cili njëherit është i obliguar të zbatojë dhe të jetësojë Statutin e **REK**.
2. Kryetari i **REK** i jep llogari kryesisë në rast se kryetari vepron në kundërshtim me statutin e **REK** si edhe kur i shkakton dëm partisë me ç'rast hapet procedura e caktimit të fajësisë dhe në rast nevojë hapet procedura e shkarkimit të kryetarit të **REK**;
3. Si njëri organ, ashtu edhe tjetri munden t'ia kërkojnë dorëheqjen kryetarit të **REK** në rast se konstatohet fajësia e tij.
4. Kryetari i **REK** nga të gjithë anëtarët e partisë kërkon llogari për obligimet që dalin nga ky Statut.
5. Të gjithë të angazhuarit në organe të ndryshme të partisë kanë për detyrë që t'i zbatojnë urdhërat e eprorëve sipas hierarkisë, për mos zbatimin e urdhrave hapet procedura në Komisionin disiplinor, dhe i shqiptohet masa disiplinore sipas fajësisë, dhe sipas akteve normative të cilat janë në fuqi.
6. Për hapjen e procedurës për shqiptimin e masave disiplinore duhet të aprovohet vendimi, votohet në frymën parlamentare dhe me 51% të votave të pranishmëve merret vendimi.

Neni 16

Kryesia formon trupat e saja ndihmëse sikurse janë

1. **Komisioni statutarë**
2. **Komisioni mbikëqyrës**
3. **Komisioni kadrovik**
4. **Gjykatën e nderit dhe**
5. **Këshillat e nevojshme profesionale.**

GRUPI PARLAMENTARË

Neni 17

Republikanet e Kosovës me rastin e hyrjes në parlamentin e Kosovës formojn grupin parlamentarë. Grupi parlamentarë angazhohet për realizimin e qëndrimeve të **Republikanëve të Kosovës** në parlament. Grupi parlamentarë i **REK** i përmbahet me përpikëri Programit dhe Satuti Partiak.



Neni 18

Anëtarët e grupit parlamentarë të **REK** zgjidhën për afat të caktuar të kohëzgjatjes së parlamentit.

Anëtari i grupit të parlamentit përfaqëson bazën dhe qëndrimet partiake.

Anëtari i grupit parlamentarë në rast të lëndimit të dispozitave të Statutit, si dhe ligjit mund të revokohet para kohe në bazë të kërkesës së bazës deleguese ose kryesisë së **REK**. Anëtari revokohet gjithashtu para kohe në rast të avancimit.

KONGRESI

Neni 19

- 1. Si formë e organizimit partiak , është tubimi i veçantë dhe solemn, në të cilin analizohen: Rezultatet e arritjeve kohore në mes të dy mandateve të kuvendit dhe kryesisë së REK.**
- 2. Kuvendin e jashtëzakonshëm e thërret kryetari i Kryesisë, respektivisht kryesia e Partisë si edhe 51% të anëtarëve-delegatëve të Kuvendit.**

Neni 20

Kongresi i rregullt mbahet çdo 4 vite.

Kongresi i jashtëzakonshëm thirret nga **Kuvendi i Republikanëve të Kosovës**, nëse është e nevojshme, ose kur për këtë votojnë ma shumë se gjysma e anëtarëve, ose kur për këtë kërkojnë 2/3 e një dege të partisë.

Publikimin për mbajtjen e kongresit të rregullt e bënë kuvendi i partisë 30 ditë pas datës së mbajtjes së Kongresit, ndërsa materiali u dërgohet delegatëve së paku 15 ditë para mbajtjes së Kongresit. Rëndin ditës për punimet e kongresit e cakton Kuvendi i **REK**.

Neni 21

Kongresi vendosë mbi pikësynimet e mëtejme programore të partisë, Aprovon programin e Partisë, gjegjësisht bënë ndryshimin dhe plotësimin e Programit. Me punën e kongresit udhëheqë kryesia e punës numri i të cilëve caktohet me rregulloren e Kongresit.

Në Kongres shqyrtohen raportet e punës në mes të dy Kongreseve. Kryetari i **Republikanëve të Kosovës** për punën e bërë në mes të dy kongreseve e njofton Kongresin.

Neni 22

Kongresi emëron Komisionet ndihmëse të nevojshme për mbarëvajtjen e Kongresit.

Kongresin e përbëjnë delegatët e deleguar nga kuvendet degëve, brenda dhe jashtë vendit.

Çdo degë dërgon nga 6 delegat në Kongres.

Në Kongres gjithashtu marrin pjesë më të drejtë fjale edhe anëtarët e kuvendit të **Republikanëve të Kosovës**.

GJYKATA E NDERIT

Neni 23

Gjykata e nderit shqyrton parashtrirat e bëra nga Kongresi. Anëtarët e gjykatës së nderit i emëron, dhe i shkarkon Kryesia, ndërsa për punën e vet i janë përgjegjës po këtij organi. Trupi i gjykatës së nderit përbëhet prej 5 anëtarëve me mandat 4 vjeçar. Gjykata e nderit shqipton masat partiake të parapara në nenin 27 të këtij Statuti. Ankesa ndaj vendimit të lëshuar nga gjykata e nderit parashtrihen në afat prej 8 ditësh përmes kësaj gjykate kryesisë së **PRK**. Detyrat e gjykatës së nderit ma detalisht do të parashihen në rregulloren e punës.



ANËTARSIMI

Neni 24

Anëtarësimi në **Republikanet e Kosovës** bëhet me vetë dëshirë duke e respektuar dhe vullnetin e lirë të individit i cili pranon Programin dhe Statutin e **REK**. Anëtarësimi nuk i siguron anëtarit kurrfarë privilegjesh apo tretman të veçantë në shoqëri. Anëtarë i **Republikanëve të Kosovës** mund të behët çdo individ i moshës madhore pa dallim gjinie, race përkatësisë kombëtare, apo fetare.

Neni 25

Anëtarësimi i një qytetari bëhet edhe në bazë të propozimit të një anëtarit të **Republikanëve të Kosovës**, anëtarit i cili e bënë propozimin për qytetarin për pranimin në radhët e Republikanëve jep arsyetimin me shkrim për propozimin e bërë.

Vendimin për pranimin e anëtarit të ri e bënë Kryesia e Degës, respektivisht e Nëndegës. Nëse kryesia përkatëse nuk i përgjigjet anëtarit brenda 15 ditësh, nga dita e paraqitjes së kërkesës, anëtarit konsiderohet i pranuar në radhët e **Republikanëve të Kosovës**.

Neni 26

Çdo anëtarë i **REK** ka të drejt dhe obligim moral të merr pjesë në mbledhjet e thirrura Partiake. Anëtarit i Partisë ka të drejtë të marr pjesë në përcaktimin e vijës Politike, dhe të paraqet mendimin e tij mbi të gjitha çështjet Partiake.

Anëtarit i Partisë ka të drejtë të zgjedhë, dhe të zgjidhet në organet Partiake. E drejtë e çdo anëtarit të **REK** është që të informohet për të gjitha vendimet Partiake. Anëtarit i **REK** është i obliguar që ti kryej detyrat e besuara dhe ti ruaj Sekretet Partiake, nëse anëtarit nuk i kryen detyrat e besuara dhe parashtruara nga Organet **REK** dhe pasojnë masat Partiake.

Neni 27

Çdo anëtarë i **REK** me rastin e pranimin pranon edhe librezën e anëtarësimit. Libreza është dëshmi më të cilën vërtetohet se poseduesi është anëtarë i **REK**, në librezë vendoset fotografia e anëtarit dhe shenimet për anëtarin. Aty mund të shënohet edhe deklaratat politike.

LARGIM - SHKARKIMI

Neni 28

Anëtarit të **Republikanëve të Kosovës** për lëshimet, gabimet gjegjësisht dëmet e shkaktuara ndaj Partisë i shqiptohen këto masa:

1. Vërejtje paraprake

2. Vërejtja e fundit

3. Largimi Përfundimtar nga Partia e REK

Këto masa Partiake i shqipton trupi i gjykatës se nderit në bazë të rregullores se sajë.

Anëtarit ka të drejtë ankese ndaj Kryesisë së Partisë në afat prej 8 ditësh nga dita e pranimin të vendit për shqiptimin e masës ndëshkuese.



Neni 29

Largimi ose përjashtimi i anëtarit të **Republikanëve të Kosovës** mund të bëhet për këto shkaqe:

- **Për mos respektimin, dhe mos zbatimin e programit dhe Statutit të REK.**
- **Zhvillim i veprimtarisë të dëmshëm, brenda dhe jashtë Partisë.**
- **Mos respektimit të kodeksit moral të anëtarit.**
- **Vetë largimi me arsyetimin e bërë me shkrim.**
- **Anëtarët dhe Anëtarët e larguar nga Partia nuk kanë të drejt të rikthehen.**

Neni 30

Shkarkimi i anëtarit mund të bëhet në këto raste:

1. **Vetë shkarkimi nga pozita Partiake më deklaratë të parashtruar nga vet anëtari.**
2. **Shkarkimi i parakohshëm për avancim.**
3. **Shkarkimi për shkaqe të mos kryerjes së detyrave.**

ORGANIZATAT JASHTËPARTIAKE

Neni 31

Republikanët e Kosovës në gjirin e sajë formon edhe organizata jashtë Partiake sikurse janë:

1. **Forumi i Gruas**
2. **Forumi Rinorë dhe**
3. **Organizatën e Pionirëve**

Neni 32

Organizatata jashtë Partiake formohen me qëllim që të forcohet lidhja në mes të popullit dhe Partisë në një formë komplementare për realizimin e interesave gjithë popullore.

Republikanët e Kosovës e shofin ardhmërinë në brezat e rinjë, si dhe në ngritjen e tyre në pikëpamje ideore dhe kombëtare.

Organizatata jashtë Partiake mund të formojnë në gjirin e tyre shoqëri të ndryshme kulturore artistike etj. Çdo organizatë jashtë partiake përgatitë Programet dhe Statutet e veta.

VEPRIMTARIA BOTUESE

Neni 33

Republikanet e Kosovës për hirë të informimit sa ma të mirë të anëtarëve të saj si dhe të opinionit të gjerë boton gazetën e sajë me emërtim "**REPUBLIKANI**".

Vendimin për themelimin e kësaj gazete e aprovon Kuvendi i **REK**.

Kryeredaktorin e gazetës e emëron Kryesia e **Republikanëve të Kosovës**. Kryeredaktori për punën e vet i përgjigjet kryesisë së **REK**.



FINANCIMI

Neni 34

Burimet e mjeteve për financimin e punës dhe veprimit të **REK** janë:

1. Mjetet e ndara nga ana e këshillit Republikan të financave.
2. Burimet e veçanta të donatorëve brenda dhe jashtë vendit.
3. Burimet e mjeteve të tubuara nga anëtarësimi.
4. Mjetet e realizuara nga marketingu i shtypit.
5. Ruajtja e mjeteve financiare bëhet në xhironlogarinë e **REK**.

Të drejtën e deponimit dhe të tërheqjes së mjeteve, si dhe nënshkrimet e kanë Kryetari i **REK** dhe personat e autorizuar nga Kryesia.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 35

1. **Republikanet e Kosovës** formojnë komisionet e nevojshme për zbatimin e zgjedhjeve Partiake, si dhe për zbatimin e zgjedhjeve të përgjithshme parlamentare. **Republikanet e Kosovës** pushojnë së vepruari me vendim të veçantë, të miratuar nga Këshilli drejtues dhe Kuvendi: në bazë të vendimit të Këshillit drejtues dhe të Kuvendit, dhe në pajtim me rregulloren mbi Partitë Politike, mjetet, pasuria e saj u shpërndahen asociacioneve humanitare, shkollave, spitaleve etj.

Neni 36

Referendumi si formë më demokratike e vendosjes se popullit zbatohet mbi çështjen esenciale dhe më primare për tërë popullin.

Neni 37

Kryesija dhe Këshilli Drejtues i Partisë mund të vendosë për bashkimin, shkrirjen me ndonjë Parti tjetër, duke iu mbështetur Programeve Politike të Partive që shprehin interesim për bashkim ose për shkrirje në njërin nga Partitë e interesuara për integrim.

Neni 38

Për zgjedhjen e kontesteve eventuale është kryesia e **REK** por vendim sjellë Kuvendi i Partisë, nëse N.N. anëtari nuk është i kënaqur edhe me vendim të Kuvendit të Partisë atëherë kontestin e zgjedh gjykata kompetente për punë civile.

Neni 39

Këtë Statut e aprovon kuvendi Republikan i Kosovës me shumicën e votave, i njëjti hyn në fuqi në ditën e aprovimit.

Kryesia e Republikanëve të Kosovës

Me 03 Mars 2014, Prishtinë

